



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr.301/5 prot.

Tiranë, 14.8.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 32, datë 5.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Alma Brati.
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.7.2018, është njoftuar vendimi nr. 32, datë 5.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Alma Brati, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 32, datë 5.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke qenë kandidate për anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor¹, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi në kohë.

2. Mbështetur në nenin Ç, pika 1, e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin znj. Alma Brati ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim referuar si Inspektorati), nga të cilët rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Alma Brati²” ka referuar për subjektin se:

- i. ka kryer deklarin të saktë në përputhje me ligjin;
- ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. nuk ka kryer deklarin të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i ka referuar Komisionit³:

- i. Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

2.3 Inspektorati i KLD-së, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit⁴ raportin për aftësitë profesionale, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku (5), Komisioni nuk ka gjetur elemente që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

¹ Referuar nenit 276 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

² Protokolluar pranë KPK-së me shkresën nr. *** prot., datë *.11.2017.

³ Protokolluar pranë KPK-së me shkresën nr. ** prot., datë **.11.2017.

⁴ Përcjellë me shkresën nr. ****/* prot., datë **.12.2017.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli në mënyrë të përmbledhur janë si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë. Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të subjektit, krahasuar me deklaratën “Vetting”, kontrolli i gjendjes pasurore, burimin e krijimit, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Nga kontrolli financiar-ligjor për 2 pasuri të paluajtshme, një autoveturë, të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *“...subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklaratimet ndër vite për sa i përket shtesave dhe pakësimeve nga të ardhurat... subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi me dokumentacion aftësinë paguese të ish-bashkëshortit për pensionin ushqimor, si dhe marrjen e pensionit ushqimor nga ana e tij... subjekti ka mungesa të ardhurash në shuma të papërfillshme... Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë... Duke analizuar gjetjet e mësipërme, këto pasaktësi dhe mospërputhje nuk u gjykuan si indicie që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara apo fshehje të pasurisë, pasi janë në shuma të vogla, që nuk ndikojnë ndjeshëm në nivelin e pasurisë apo të ardhurave të ligjshme të subjektit... Në këtë vlerësim u mbajt parasysh fakti që subjekti ka qenë i saktë në deklarin e bërë në deklaratën ‘Vetting’... Më tej, Komisioni arsyeton se pasaktësitë në deklaratimet e viteve të kaluara nuk lidhen me deklarin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për ‘deklarim të pamjaftueshëm’, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas deklaratës ‘Vetting’, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë apo kur tenton të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë. Komisioni çmon se subjekti, pavarësisht se ka pasur pasaktësi në deklaratime apo mungesë të të ardhurave në momente të caktuara, përgjatë deklaratimeve të pasurisë ndër vite nuk ka pasur për qëllim të fshehtë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë... Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të veta, si detyrim kryesor kushtetues të tij”. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti znj. Alma Brati ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë (f. 29-30 e vendimit).*

4. Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë

ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

5. Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga Inspektorati i KLD-së⁵, hetimit dhe vlerësimit të 5 denoncimeve nga publiku, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

6. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II. Shkaqet e ankimit

7. Mbështetur në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin C, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisionerët Publikë, si një ndër tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, ka të drejtën e paraqitjes së ankimeve kundër vendimit të Komisionit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

8. Në identifikimin e shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik mban në konsideratë mbrojtjen e interesit publik dhe paraqitja e tyre pranë juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit bëhet me qëllim që procedura e rivlerësimit kalimtar për subjektet e rivlerësimit të kryhet në mënyrë të plotë mbi bazën e përcaktimeve kushtetuese e ligjore për secilin kriter kontrolli.

9. Komisioneri Publik vlerëson se vendimi nr. 32, datë 5.7.2018, përmban mangësi në hetimin dhe kontrollin e kriterit të pasurisë. Arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit, në vështrim të provave të administruara, nuk të krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, referuar kërkesave të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

⁵ Bazuar në formularin e vetëdeklarimit, 5 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezultojnë se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit, tetor 2013-tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur gjithsej 2 ankesa në KLD. Të dyja këto ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

10. Komisioneri Publik çmon se mangësitë e konstatuara në hetimin dhe vlerësimin drejt të fakteve nga ana e Komisionit për kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit justifikojnë rishikimin e vendimit. Mangësitë e vërejtura mund të rregullohen nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, referuar nenit F, pika 3, dhe 7 të aneksit të Kushtetutës.

11. Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, F, pika 3, dhe 7 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4 e 66 të ligjit nr.84/2016, në vijim paraqesim shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Brati.

12. Paraprakisht, në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit mbështeten në këto çështje:

12.1 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, apartamentit në ***** referuar nenit D pika 3 të aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 14, 30 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk ka hetuar dhe administruar asnjë provë mbi burimin dhe ligjshmërinë e huasë në shumën 25.000 euro dhe dhurimit të shumës 1.800.000 lekë, që ka shërbyer për shlyerjen e huasë. Në të dyja rastet, Komisioni është mjaftuar me gjendjen e faktit, pasja e llogarive bankare nga ana e personave të lidhur dhe deklaratat noteriale të dorëzuara nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

12.2 Për shumën totale 3.160.000 lekë, përfituar nga subjekti si e ardhur nën regjimin ushqimor, Komisioni nuk ka hetuar burimin dhe ligjshmërinë e tyre. Këto të ardhura deklarohen, por nuk ka asnjë dokument provues mbi vërtetësinë dhe ligjshmërinë e tyre, fakt ky i cili ndikon në analizën negative financiare mbi likuiditetet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit.

12.3 Subjekti i rivlerësimit prej deklarimit të parë të interesave private e në vijim ka qenë e pasaktë dhe ka kryer deklarim të rremë, reflektuar edhe në deklaratën “Vetting”, në kundërshtim kjo me nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016.

12.4 Komisioni nuk ka hetuar burimin e ligjshëm të huasë prej 3.200 euro, marrë prej subjektit të rivlerësimit për mbylljen e kredisë, me qëllim rikonstruksionin e banesës në *****. Komisioni nuk ka hetuar shkakun e mospërputhjes midis sipërfaqes truall të banesës në ***** , regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëpronarëve të tjerë, me sipërfaqen e tjetërsuar në kontratë.

II. A Mangësitë e konstatuara, vlerësimi i Komisionerit Publik për kontrollin e kriterit të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit

13. Në nivel kushtetues, si një ndër shtyllat e rivlerësimit kalimtar, kontrollin e pasurisë e gjejmë të rregulluar në nenin D të aneksit të Kushtetutës, ku detyrimi themelor i subjektit në

raport me procesin e rivlerësimit është se ai duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të tij. Ndërkohë në nivel ligjor, referuar nenit 30 të ligjit 84/2016, objekt kontrolli i këtij kriteri përfshin edhe elementet, si: deklarimi dhe kontrolli i pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

14. Nën dritën e këtyre parashikimeve, vlerësimi për kontrollin e këtij kriteri në vijim bazohet në analizën juridiko-financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur me të, të cilat vërtetohen me anë të dokumenteve zyrtare të institucioneve publike e private dhe ato të dorëzuara nga vetë subjekti, deklarimet periodike të interesave privatë dhe ajo “Vetting”, nëse subjekti ka bërë deklarim të mjaftueshëm dhe të saktë konform kërkesave ligjore. Verifikimi i llogarive bankare, përmbushja e detyrimeve tatimore/financiare, ligjshmëria e likuiditeteve të deklaruara si gjendje *cash*, llogari bankare, asetet pasurore, burimi dhe ligjshmëria e krijimit dhe veprimet juridike për disponimin e tyre etj.⁶

15. Në lidhje me shkakun e parë. Nga vlerësimi i provave të administruara në fashikullin e Komisionit për apartamentin në pronësi të subjektit në ***** rezulton se Komisioni nuk ka hetuar dhe arsyetuar mbi burimin e ligjshëm të huasë 25.000 euro dhe dhurimit 1.800.000 lekë, që ka shërbyer për shlyerjen e kësaj huaje.

15.1 Subjekti i rivlerësimit në vitin 2015 ka deklaruar blerjen e një apartamenti në ***** për çmimin 80.000 euro, me burim krijimi, kredi bankare, hua nga një i afërm dhe kursimet në vite. Në deklaratën “Vetting” 2017, burimi i krijimit deklarohet hua bankare, hua (e shlyer) dhe kursime nga pagat.

15.2 Për burimin e krijimit të kësaj pasurie, kanë shërbyer:

- i.* Kredia e marrë nga *****⁷ në shumën 50.000 euro (7.000.000 lekë, disbursuar në datë 30.9.2015);
- ii.* Hua e marrë te znj. *.* (e afërmja e subjektit) në shumën 25.000 euro (3.441.250 lekë);
- iii.* Shuma prej 5.000 euro (688.250 lekë) mbuluar me kursimet e subjektit nga viti 2014.

⁶ Për sa i përket zërit “shpenzime jetësore”, vlerat e tyre janë marrë të mirëqena, referuar llogaritjeve nga ILDKPKI-ja, përpjesëtuar për frymë dhe për llogaritur sipas përbërjes në certifikatën familjare.

⁷ Në datë **.9.2015, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e huasë nr. **** rep. dhe nr. **** kol. me “*****” për shumën 50.000 euro, me afat shlyerje 240 muaj/20 vjet. Në këtë kontratë huaje ka nënshkruar edhe shitësi *. ***** në cilësinë e hipotekuesit, ku ka lënë garanci pasurinë që do t’ia shiste subjektit të rivlerësimit.

15.3 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, është fokusuar në marrëdhënien e huasë 25.000 euro, marrë prej znj. *. * dhe shlyerjen e këtij borxhi me anë të shumës 1.800.000 lekë, dhuruar nga znj. *. * (e ëma) dhe 1.700.000 lekë nga kursimet e subjektit.

15.3.1 Marrja e huasë në shumën 25.000 euro nga ana e subjektit provohet nga dy vërtetimet e tërheqjes pranë ***-**, ku tërheqja e parë në shumën 15.000 euro rezulton në datë 4.9.2015 dhe tërheqja e dytë në shumën 10.000 euro, në datë 17.9.2015. Për hetimin e burimit të ligjshëm, Komisioni është ndalur vetëm në vlerësimin e aftësisë së znj. *. * për të dhënë hua shumën 25.000 euro, nga i cili ka rezultuar se znj. *. * ka pasur ose ka llogari bankare në katër banka të nivelit të dytë. Bazuar në faktin e pasjes së llogarive bankare, Komisioni ka çmuar se znj. *. * i ka pasur mundësitë financiare për dhënien e kësaj huaje (f.10-11 e vendimit).

15.3.2 Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar se huaja e sipërcituar është shlyer plotësisht, por për këtë fakt nuk ka dorëzuar ndonjë dokumentacion provues. Për këtë arsye, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të znj. *. * të datës **.2.2018⁸, ku deklarohet fakti “se i ka dhënë hua, formalizuar me deklaratën noteriale të shkurtit 2016 dhe se *. * e ka shlyer të gjithë shumën në gusht 2016”. Referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, ku përcaktohet se me pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme.

15.3.3 Për shlyerjen e huasë, referuar deklaratës vjetore 2016 dhe asaj “Vetting”, subjekti deklaroi kursimet e saj të viteve 2014-2016 në shumën 1.700.000 lekë dhe shumën 1.800.000 lekë, dhuruar nga znj. *. *

15.4 Për burimin e dhurimit të shumës 1.800.000 lekë, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, është ndalur në vërtetimin e aftësisë financiare të dhurueses. Për këtë qëllim, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar një deklaratë noteriale të datës *.4.2013, nënshkruar nga znj. *. * (kreditore) dhe shtetasi *. * (debitori). Me anë të këtij akti noterial, deklaruesit kanë pranuar se “z. *. * në datë *.6.2006, i ka marrë borxh verbalisht znj. *. * shumën 4.000.000 lekë për të kryer investime në hotel-restorant “XXXX” në *****. Në datën **.5.2011 i kam kthyer cash znj. *. * këstin e parë të huasë, në shumën 1.500.000 lekë, dhe ditën sotme, datë *.4.2013, i kam kthyer cash, jashtë zyrës noteriale dhe këstin e dytë dhe të fundit të huasë, në shumën 2.500.000 lekë”.

15.4.1 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar gjithashtu se znj. *. * ka pasur llogari pranë ***** me vlerë fillestare në mars 2006, shumën 12.000 euro, në maj 2006 është tërhequr shuma prej 10.000 euro dhe në shkurt 2007 është tërhequr edhe shuma e mbetur.

⁸ Nr. *** rep. dhe nr.*** kol., redaktuar nga noteri i Dhomës Noteriale ***** , znj. *. *****.

15.4.2 Nisur nga këto të dhëna bankare, Komisioni ka vlerësuar se znj *.* ka pasur aftësi financiare vetëm në shumën 10.000 euro për t'i dhënë hua shtetasit *.* ,ndërsa për pjesën tjetër (2.770.000 lekë) nuk ka asnjë dokument provues. Në lidhje me këtë fakt, subjekti ka deklaruar se shuma prej 4.000.000 lekë e ka burimin nga paga e dy prindërve të saj. Nga hetimi mbi të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 1999-2002 për familjen e subjektit, në përfundim Komisioni ka vlerësuar se *“nuk vërtetohet me dokument burimi i ligjshëm për shumën 4.000.000 lekë në pronësi të *.* dhe *.* (prindërit e subjektit), pavarësisht deklaratës noteriale të nënshkruar nga z. *.*. Kjo deklaratë mund të vërtetohet shlyerjen e huasë... por jo lëvrimin real të të hollave. Gjithashtu, nuk u provua me dokumentacion as ekzistenca e kësaj shume prej 4.000.000 lekë. Nisur nga fakti se procesit të rivlerësimit kalimtar i nënshtrohet subjekti, Komisioni çmon se fokusi i hetimit dhe vlerësimit do të duhet të jetë shuma që është përfituar nga ky subjekt. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursime në shumën 1.800.000 lekë...”. “Ky konstatim bazohet në të dhënat e administruara nga bankat dhe organet tatimore nga ku rezulton se në vitin 2006, kur subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrën e gjyqtarit, nëna e subjektit kishte të ardhura në banka në shumën 12.000 euro, vlerë e përafërt me shumën e dhuruar nga ana e saj. Në përfundim vlerësohet se shuma prej 1.800.000 lekë e përfituar nga subjekti duhet të konsiderohet si e ardhur me burime të ligjshme” (f.16 i vendimit).*

15.4.3 Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk mundet të provojë me asnjë dokument dhurimin e përfituar, Komisioni në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit Ç, pika 4 e aneksit të Kushtetutës, i është drejtuar me shkresë znj*.*, për të dhënë deklaram në lidhje me burimin e të ardhurave, shoqëruar me dokumentacion provues për shumën e dhuruar.

15.4.4 Znj. *.* në pamundësi shëndetësore për t'u paraqitur pranë Komisionit, ka nënshkruar dhe dorëzuar deklaratën noteriale të datës 19.4.2018⁹, ku deklaroi se *“... i kam dhuruar A. Brati, shumën 1.800.000 lekë për të shlyer detyrimin që kishte ndaj motrës sime *.* për blerjen e apartamentit që jetojmë aktualisht... Burimet e kursimeve janë të ardhurat nga puna ime dhe e ish-bashkëshortit. Dokumentacioni që kisha gjendje për të ardhurat ju janë dorëzuar ...”.*

15.4.5 Në përfundim të këtij hetimi, Komisioni ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara, subjekti ka pasur mundësi financiare për këtë pasuri të paluajtshme, si dhe konstatohen pasaktësi të vogla në deklarime ndër vite, por prej të cilave nuk lindin dyshime të arsyeshme për shkelje të mundshme ligjore (f.17 e vendimit).

⁹ Nr. *** rep. dhe nr. *** kol., redaktuar para noteres *. *****, në *****.

15.5 **Komisioneri Publik**, në vlerësim të provave të administruara, çmon se hetimi i Komisionit mbi këtë pasuri ka qenë i paplotë dhe përfundimet e tij kanë dalë tej parashikimeve kushtetuese e ligjore mbi kontrollin e pasurisë. Në zbatim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 14, 30 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet të hetonte dhe administronte prova mbi burimin dhe ligjshmërinë e huasë në shumën 25.000 euro dhe dhurimit të shumës 1.800.000 lekë. Kjo pasi në kuptim të nenit 3, pika 14¹⁰, të ligjit nr. 84/2016, znj. *.* (huadhënësja) dhe znj. *.* (dhuruesja) kanë pasur lidhje interesi që rrjedh nga një interes pasuror me subjektin e rivlerësimit dhe në këto kushte duhet të kualifikoheshin nga Komisioni në cilësinë e personit tjetër të lidhur. Në këto kushte, në zbatim të nenit 32, pika 4,¹¹ të ligjit 84/2016, duke qenë se me deklaratat noteriale respektive konfirmohen këto marrëdhënie, personat e tjerë të lidhur *.* dhe *.* duhet t'u kalonte detyrimi për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave, dhënë hua dhe dhuruar subjektit të rivlerësimit.

15.5.1 Standardi kushtetues e ligjor që dispozitat e sipërcituara përcaktojnë mbi kontrollin e pasurisë dhe detyrimi për justifikimin në mënyrë bindëse të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë nga ana e subjektit, nuk pajtohet me përfundimet e arritura nga ana e Komisionit bazuar thjesht në gjendje fakti se duke pasur llogari bankare huadhënësja apo dhuruesja kanë pasur aftësi financiare për t'i siguruar subjektit të rivlerësimit shumat përkatëse. Pasja e një llogarie bankare nuk ligjëron dhe justifikon burimin e saj. Subjekti i rivlerësimit dhe shtetaset znj. *.* dhe znj. *.* këto të fundit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, kanë pasur detyrimin ligjor për të provuar dhe justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave që subjekti i ka përdorur për krijimin e pasurisë¹².

15.5.2 Lidhur me pretendimin e subjektit se familja e saj mund të akumulonte shumën 4.000.000 lekë¹³ për periudhën 1967-2014 (nga të cilat përfitoi në formë dhurimi 1.8 milionë lekë), referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit për periudhën 1999-2001¹⁴, rezulton se i ndjeri *.* ka qenë i regjistruar si person fizik, duke deklaruar pranë

¹⁰ “14. “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, Komisionerin, gjyqtarin ose Komisionerin Publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

¹¹ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

¹² Gjatë hetimit administrativ, referuar pyetësorit të datës *.2.2018, Komisioni e ka pasur në konsideratë këtë fakt, kur i kërkon subjektit “na informoni mbi burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, duke pasur parasysh konceptin ligjor të ligjshmërisë së të ardhurave” për shumën 4.000.000 lekë, nga e cila subjekti përfitoi 1.800.000 lekë në formën e dhurimit.

¹³ Kjo shumë deklarohet nga subjekti se prindërit e kanë mbajtur një pjesë *cash* dhe një pjesë në llogari bankare.

¹⁴ Provuar me vërtetimet e paraqitura nga Drejtoria Rajonale *****, me shkresën nr. ***/* prot., datë *.2.2018.

organeve tatimore, ndërsa për znj. *.* nuk është administruar ndonjë e dhënë për të ardhurat e saj.

Tabela mbi të ardhurat nga puna si person fizik të *.* 1999 -2002

Xhiro vjetore		Paguar tatim	Paguar sig. shoq.	Qira zyre	Fitimi neto/ lekë
Viti 1999	200,000	23,350	0	96,000	80,650
Viti 2000	1,100,000	80,000	79,740		1,020,000
Viti 2001	1,220,000	72,000	93,276		1,148,000
Viti 2002	644,000	150,000	0	96,000 ¹⁵	398,000
Fitimi gjithsej					2,646,650
Shpenzime jetese ¹⁶					480,000
Detyrimi për të paguar 1/2 e vlerës së shtëpisë në ***					975,000
Diferenca e mbetur					1,191,650

15.5.3 Rezulton se z. *.* deri në vitin 2002 ka përfituar shumën 2,646,650 lekë dhe diferenca e mbetur pas pagesës për ½ pjesë takuese të shtëpisë në ***** dhe shpenzimeve të jetesës është 1,191,650 lekë. Për sa i përket të ardhurave të krijuara përpara vitit 1999 dhe pas vitit 2002 nuk gjejmë dokumentacion i cili të vërtetojë burimin e tyre. Në këto kushte, për vitin 2006, kur znj. *.* ka dhënë hua shumën 4.000.000 lekë shtetasit *.*., nuk gjenden dokumente ligjore për të vërtetuar ekzistencën apo burimin e krijimit të tyre. Ndërsa për sa i përket shumës prej 1,800,000 lekë (nga shuma 4.000.000 lekë) dhuruar nga znj. *.* për shlyerjen e borxhit në vitin 2016 ndaj znj. *.*., Komisioni është mjaftuar me faktin se: *“... ka rezultuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursime në shumën 1,800,000 lekë. Ky konstatim bazohet në të dhënat e administruara nga bankat, si dhe organet tatimore, nga ku rezulton se në vitin 2006...nëna e subjektit të rivlerësimit kishte të ardhura në bankë në vlerën 12 000 euro, vlerë e përafërt me shumën e dhuruar nga ana e saj subjektit të rivlerësimit. Në përfundim vlerësohet se shuma prej 1 800 000 lekësh, e përfituar nga subjekti duhet të konsiderohet si e ardhur me burime të ligjshme”*.

15.5.4 Ky konkluzion i Komisionit, përveç faktit se nuk provon ligjshmërinë e burimit, i bazuar në pasjen e llogarisë bankare, vlerësojmë se është i paplotë, pasi nuk mbështetet në asnjë analizë financiare.

15.5.5 Referuar lëvizjeve bankare, pranë ***** *****, konstatojmë se znj. *.* ka depozituar një shumë prej 12.000 euro, në datë **.3.2006, dhe e ka tërhequr dhe mbyllur

¹⁵ Referuar dokumentacionit të paraqitur në shkresën e DRT *****, me shkresën nr. ***/* prot., datë *.2.2018, qiraja e zyrës është e dokumentuar vetëm për dy vite, pra në vitin 1999 ndodhet kontrata noteriale e qirasë, ndërsa në vitin 2002 ekziston pagesa e tatimit të qirasë së zyrës, si rrjedhim kemi konsideruar si shpenzim të zbritshëm qiranë 96. 000 lekë/vit.

¹⁶ Për shpenzimet e jetesës, në pamundësi për të pasur të dhëna zyrtare të shpenzimeve në këto vite, u jemi referuar shpenzimeve të cilat Komisioni ka marrë në konsideratë gjatë analizës.

Ilogarinë në datë **.5.2006. Ndërkohë, shlyerja e borxhit ndaj znj. *.* referuar deklaratës noteriale të shkurtit 2018, është kryer në gusht të vitit 2016. Na rezulton gjithashtu se në analizë, në zërin e shpenzimeve të dhurueses duhet të konsiderohen edhe ato të kryera gjatë periudhës 2006-2016, të tilla si pagesat e kësteve të kredisë në bankën ***** pagesat e qirasë së shtëpisë nga viti 2007 e në vazhdim deri në vitin 2016, analizë nga e cila rezulton e qartë se dhuruesja ka qenë në pamundësi financiare dhe pa asnjë burim të ligjshëm për sigurimin e një shume të tillë.

15.5.6 Vlen të theksohet gjithashtu se për dhurimin e 1.800.000 lekë, subjekti ka pasur detyrimin ligjor që në bazë të nenit 4, pika “i”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të paguante tatimin në burim, fakt i cili nuk rezulton i hetuar apo provuar. Referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, ku përcaktohet se *me pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*, kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme.

16. Në lidhje me shkakun e dytë. Për shumën totale 3.160.000 lekë, përfituar nga subjekti si e ardhur nën regjimin ushqimor, Komisioni nuk ka hetuar burimin dhe ligjshmërinë e tyre. Për këto të ardhura nuk ka asnjë dokument provues mbi vërtetësinë dhe ligjshmërinë e tyre, fakt i cili ndikon edhe në analizën financiare negative mbi likuiditetet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit.

16.1 Në deklaratën “Vetting” 2017, subjekti deklaroi se i ka përfituar këto të ardhura për periudhën 2007-2014, në shumën 1.960.000 lekë dhe shumën 1.200.000 lekë për periudhën 2015-2016, total 3.160.000 lekë. Kjo shumë është kontradiktore me deklaratimet e subjektit gjatë deklaratave periodike dhe shpjegimet e saj të datës **.5.2018, nga të cilat rezulton se shuma totale është 2.920.000 lekë, pra me një mospërputhje prej 240.000 lekë.

16.2 Megjithëse këto shuma relativisht të mëdha janë deklaruar nga subjekti si të ardhura për mbulimin e shpenzimeve, likuiditeteve të krijuara dhe blerjen e makinës, për to nuk është provuar dhe justifikuar burimi i ligjshëm. Subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj nuk kanë depozituar asnjë dokumentacion provues, me pretendimin se është kryer në marrëveshje dhe gjithnjë është bërë *cash*.

16.3 Komisioni arsyeton në këtë rast se subjekti ka si persona të lidhur dy fëmijët, të cilët i përfitojnë këto të ardhura dhe pensioni nuk është e ardhur e tatueshme në bazë të legjislacionit financiar dhe pavarësisht se nuk u vërtetua me dokumentacion aftësia paguese e ish-bashkëshortit, kjo barrë nuk mund t’i ngarkohet subjektit të rivlerësimit.

16.4 **Komisioneri Publik** vlerëson se ky arsyetim nuk qëndron dhe hetimi në këtë drejtim është i paplotë. Sipas deklaratimeve të vetë subjektit, kjo e ardhur është përdorur edhe për qëllime

të tjera dhe ka shërbyer si burim krijimi pasurie. Në këto kushte, barra për justifikimin e ligjshmërisë duhet ti kalonte si subjektit dhe ish-bashkëshortit të saj, këtij të fundit në cilësinë e personit të lidhur. Subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj nuk provojnë dot nëse këto të ardhura kanë pasur burim të ligjshëm, fakt ky i cili passjell dhe gjykimin nëse kjo e ardhur i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

16.4.1 Do të pajtoheshim me arsyetimin e Komisionit, *mbi të ardhurën e patatueshme* nëse ish-bashkëshorti apo subjekti i rivlerësimit do të provonin se këto shuma e kanë burimin nga të ardhurat nga puna apo nga një burim tjetër të vërtetueshëm e për të cilat provohet me rekorde tatimore mbi këtë veprimtari, në kuptim kjo edhe të nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës. Nisur nga arsyetimi i Komisionit, e njëjta logjikë nuk qëndron edhe për pjesën tjetër prej 30.000 lekë, që plotëson shumën 50.000 lekë, të cilën subjekti pranon se e ka përfituar nën këtë regjim nga janari 2015 e në vazhdim, referuar deklaratës noteriale të datës ** janar 2017. E thënë ndryshe, diferenca në këtë rast përbën shumën 720.000 lekë, e që përkon me periudhën 2015-2016.

16.4.2 Pamundësia financiare e ish-bashkëshortit për të garantuar shuma të tilla *cash* vërtetohet edhe nga përgjigjja e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, *****, dërguar me shkresën nr. ****/* prot., datë *.4.2018, ku nga verifikimi i sistemit elektronik të subjekteve tatimpaguese, ky subjekt nuk ka asnjë deklaratë tatimore të dorëzuar në ushtrim të aktivitetit të tij, si dhe nuk gjenden të dhëna as në dokumentacionin e arkivuar.

16.4.3 Ky fakt, si dhe pranimi nga ish-bashkëshorti gjatë pyetësorit të Komisionit, të datës **.4.2018, “*se shumën 1.000.000 lekë i kishte marrë hua tek disa shokë*” (f. 27 e vendimit), cënon vërtetësinë dhe qëllimin e deklaratës noteriale të janarit 2017, dorëzuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Referuar nenit 49, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe praktikave të tjera të ngjashme, ku Komisioni gjatë hetimit administrativ nuk ka pranuar deklarata noteriale, ky akt nuk mund të përbënte provë të besueshme dhe të pranohej nga Komisioni.

16.4.4 Si përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, të ardhurat e siguruara nga ish-bashkëshorti i subjektit nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, Komisioni nuk ka administruar asnjë dokument provues. Mosjustifikimi i ligjshmërisë së këtyre të ardhurave ndikon dhe reflektohet edhe në analizën financiare mbi likuiditetet e subjektit dhe burimit të krijimit të asetit, makinë, të cilat rezultojnë negative. Kështu, për vitet 2011, 2012 dhe 2013, subjekti rezulton me pamundësi financiare për pagimin e shpenzimeve të deklaruara, respektivisht në shumat: - 872.988 lekë, - 361.617 lekë dhe - 668.005 lekë. I njëjti fakt rezulton edhe për likuiditetet e deklaruara si të kursyera për vitet 2014 dhe 2015 me nga 1.100.000 lekë, respektivisht. Nga

analiza financiare e kryer për këto vite rezulton se subjekti ka pamundësi financiare për mbulimin e likuiditeteve dhe shpenzimet e deklaruara, përkatësisht shumë: - 641.775 lekë dhe - 4.593.049 lekë. Viti 2015 përkon dhe me blerjen e apartamentit në *****.

17. Në lidhje me shkakun e tretë. Subjekti i rivlerësimit prej deklarimit të parë të interesave privatë (2007) e në vijim ka qenë i pasaktë dhe ka kryer deklarim të rremë, reflektuar edhe në deklaratën “Vetting”.

17.1 Konstatojmë se subjekti prej deklarimit të parë në vitin 2007 e deri në deklaratën “Vetting” ka qenë i pasaktë e në disa raste ka kryer deklarim të rremë apo mosdeklarim, veprime këto të cilat bien ndesh me nenin D¹⁷ të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, ku objekt vlerësimi përfshin deklarimin, saktësinë dhe kontrollin e pasurisë. Nën këtë logjikë, ligjvënësi ka përcaktuar në nenin 32, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, se deklaratimet e interesave privatë dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit, me qëllim që këta të fundit, si dy organet parësore në kryerjen e procesit të rivlerësimit, në krahasim me deklaratën “Vetting” (neni D, pika 2 e aneksit të Kushtetutës), të vlerësojnë dhe vendosin nëse subjekti ka deklaruar saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasurinë. Ky vlerësim është determinant në përcaktimin nëse subjekti i kontrolluar ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë (neni 59/1 në lidhje me nenin 61/3 të ligjit) apo subjekti është përpjekur të fshehë, paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim apo përdorim (neni D, pika 5 e Kushtetutës).

17.2 Në vështrim të sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në vitin 2009, ku deklaroi shlyerjen e kredisë bankare (për qëllime të shtëpisë në *****), në shumën ¼ të 4.000 USD, ndërkohë nga hetimi ka rezultuar se ka marrë një borxh të padeklaruar në shumën 3.200 euro.

17.3 I njëjti fakt qëndron edhe në vitin 2012, subjekti nuk deklaroi shitjen e një autoveture “*****” 100.000 lekë, të ardhura që nuk janë deklaruar as në deklaratën “Vetting” 2017. Në deklaratën vjetore 2013, subjekti deklaroi të ardhura nga pensioni ushqimor në shumën 620.000 lekë, ndërkohë në 2012 i kishte deklaruar në shumën 240.000 lekë.

18. Në lidhje me shkakun e katërt. Komisioni nuk ka hetuar burimin e ligjshëm të huasë prej 3.200 euro, marrë prej subjektit të rivlerësimit për mbylljen e kredisë, me qëllim rikonstruksionin e banesës në *****. Komisioni nuk ka hetuar shkakun e mospërputhjes midis

¹⁷ D/1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, **me qëllim... ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe personave të lidhur.**

sipërfaqes truall të banesës në *****, regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëpronarëve të tjerë, me sipërfaqen e tjetërsuar/disponuar në kontratë.

18.1 Në deklarin e interesave pasurorë për vitin 2007 dhe më pas në atë “Vetting” 2017, subjekti deklaroi edhe një apartament në *****, me sipërfaqe 85.34 m² ndërtimi dhe truallin funksional me sipërfaqe 179.84 m², në bashkëpronësi me familjarët e saj, blerë sipas pjesës takuese në vitin 2002, me burim krijimi të ardhurat nga pagat.

18.2 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar problematika e regjistrimit në emër të palës blerëse, pasi ZVRPP-ja *****, me shkresën nr.*****/* prot., datë **.1.2018, i ka përcjellë Komisionit të dhënat për regjistrimin, nga të cilat kontrata e shitblerjes ndryshon me atë të përcjellë nga ana e noterit *.*

18.3 Nga shqyrtimi dhe krahasimi i dy kontratave, pretendimeve të noterit dhe subjektit, vlerësojmë se krijohen dyshime të arsyeshme se kontrata në dy versionet e saj:

- i. Nuk është përpiluar në të njëjtën ditë, pasi, me të njëjtin numër repertori dhe koleksioni, janë nënshkruar akte me përmbajtje të ndryshme në disa elemente.
- ii. Edhe nëse pretendimi i noterit (ku fillimisht me shkresën nr. ***** datë. **.12.2017, shprehet se “*është redaktuar vetëm një kontratë...*”), se redaktimi i dy kontratave ka ndodhur për shkaqe teknike, qëndron, ai ka pasur detyrimin ligjor të përmendë në akt këto ndodhi të pretenduara, për më tepër kur ato ndikojnë në elemente kontraktore të rëndësishme si: cilësimi apo saktësimi i sipërfaqes së pasurisë.
- iii. Në kontratë disponohet për truall me sip.158 m², ndërkohë sipas ç ertifikatës së pronësisë blerësit figurojnë pronarë të sip.179.84 m² truall.

18.4 Përballë këtyre fakteve, si dhe marrë në konsideratë kohën e veprimit juridik dhe regjistrimit në ZVRPP ***** shpjegimet e noterit ndaj Komisionit se “*punonjësit e hipotekës e bënë vetë ndarjen e pasurisë së tjetërsuar nga pjesa tjetër që i mbetej pronarit*” dhe kohën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë punonjëse pranë ZVRPP ***** (2003-2007, certifikata e pronësisë është lëshuar në 2004), gjykojmë se janë indicie të cilat rëndojnë mbi pozitën e subjektit të rivlerësimit. Këto rrethana duhet të detyronin Komisionin që të hetonte më tej në sqarimin e kësaj situate dhe jo të konkludonte “*se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për veprimet e noterit, të gjitha këto fakte nuk ndikojnë në marrëdhëniet korrekte të pronësisë së subjektit me pronën*” (f.18 e vendimit).

18.5 Konstatohet gjithashtu se referuar dosjes së ILDKPKI-së (f. 221), subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën reale të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”, vlerësuar në datë *.9.2013, për çmimin 18.025.520 lekë, fakt ky i pakonstatuar nga ana e Komisionit. Në kuptim të pikës 1, germa “e”, të urdhrit nr. 475 datë 11.5.2017, të Inspektorit të Përgjithshëm

të ILDKPKI-së¹⁸, mosdeklarimi i saktë i vlerës së asetëve/pasurive konsiderohet deklarim jo në përputhje me përcaktimet ligjore. Përcaktimi i detyrimeve financiare për efekt rivlerësimi të pronës do ndihmonte Komisionin edhe në analizën financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit.

18.6 Kredia 15.000 USD është marrë për qëllime të rikonstruksionit të pasurisë së mësipërme, pranë “***** ***** (sot ***** ***** ****) nga ish-bashkëshorti dhe babai i subjektit në vitin 2002, me afat shlyerje 10 vjet. Deklaruar në 2007 me qëllim “blerje shtëpie”, deklarim i ndryshuar në DV-2009, ku pasqyrohet “për rikonstruksionin e banesës në *****”. Shlyer plotësisht para kohe, në janar të vitit 2010.

18.7 Bazuar në provat e administruara në fashikullin e Komisionit, ndryshe sa pretendon subjekti i rivlerësimit, se në cilësinë e bashkëpronares, ajo së bashku me të ëmën ka nënshkruar duke dhënë pëlqimin për vendosjen e banesës si kolateral për garantimin e kredisë, nga kartelat e pasurisë, si dhe nga përmbajtja e kontratës së huasë¹⁹ nuk na rezulton një fakt i tillë. Komisioni, pa hetuar dhe ballafaquar me provat e administruara, në arsyetimin e tij i ka marrë të mirëqena pretendimet e subjektit të rivlerësimit të datës 15.3.2018.

18.8 Në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie, referuar lëvizjeve në llogarinë bankare të subjektit pranë ***** ***** **** periudha 2007-2009, rezulton se subjekti ka paguar vetëm shumën 640 USD dhe deklarimi në vitin 2009, se për mbylljen e kredisë ka paguar ¼ e 4.000 USD (1.000 USD) është deklarim i pasaktë. Kësti i fundit i kredisë është paguar në datë 21.1.2010, ku është derdhur shuma 4.475 USD dhe nga pyetëtori i Komisionit, i datës 15.3.2018, rezulton se për mbylljen e kredisë, subjekti i rivlerësimit ka marrë borxh shumën 3.200 euro (përafërsisht 4.475 USD) tek i afërmi i saj, duke pretenduar se kjo hua është shlyer nga ish-bashkëshorti i saj më pas.

18.9 Referuar arsyetimit të Komisionit dhe akteve të administruara, rezulton se për vërtetimin e këtij pretendimi nuk është hetuar dhe administruar asnjë provë. Komisioni nuk shprehet mbi burimin e ligjshëm të kësaj huaje, si e ardhur kjo që subjekti ka përdorur për mbylljen e kredisë.

18.10 Si përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se për titullin e pasurisë në ***** mosrakordimi i sipërfaqes së regjistruar në titull me atë të disponuar në kontratë dhe marrëdhënia e huasë për shumën 3.200 euro, hetimi i Komisionit ka qenë i paplotë. Veç faktit se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë për periudhën 2007-2009, nuk është deklaruar dhe nuk

¹⁸ “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”. Kontrata nuk ka asnjë përcaktim apo pasuri të identifikuar për qëllim të garancisë/kolateralit.

është justifikuar ligjshmëria e burimit të huasë prej 3.200 euro, që është përdorur për mbylljen e kredisë. Në zbatim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 4, 30 dhe nenit 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet të hetonte dhe administronte prova mbi vërtetësinë e deklarimeve të subjektit dhe ish-bashkëshortit të saj për marrëdhënien e huasë. Subjekti i rivlerësimit, duke pranuar këtë marrëdhënie, dhe huadhënësi, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, kanë pasur detyrimin ligjor për të provuar dhe justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj të ardhure, barrë provueshmërie, që në aspektin procedural duhet të provohet me fakte dhe prova gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

III. Kërkimi i ankimit

19. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vlerësim të faktit nëse vendimmarrja mbështetet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

20. Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimin e nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit C, pika 2, D, Ç dhe F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, vlerësoj se vendimi nr. 32, datë 5.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Alma Brati, nuk është konform përcaktimeve kushtetuese e ligjore mbi kriterin e kontrollit të pasurisë. Hetimi dhe analizimi i drejtë i gjendjes së fakteve nuk i përgjigjet aplikimit të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 për subjektin znj. Alma Brati;

21. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 59 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe pas hetimit të plotë të kriterit të kontrollit të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit znj. Alma Brati, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit nr. 32, datë 5.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Darjel Sina

Komisioner Publik